



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:154374

Datë: 18.01.2024

Numri i dokumentit: 05206703

**P.nr.2189/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË** - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit J.J.nga Fshati P. K O., i akuzuar për veprën penale Nxitja e urrejtjes përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4376/17 të datë 10.11.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 09.01.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu, i akuzuari J. J., me datë 12.01.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 18.01.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari J. J., i biri i M. dhe nëna S., e gjinisë K., i lindur me ....., në Prishtinë, me vendbanim fshatin P. KK O., me numër personal ....., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Serb, Shtetase e Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Me datën 19.04.2017 rreth orës 21:00 në Fshatin P. – O. i pandehuri në bashkëkryerje me të miturin F.S(ndaj të cilit është veçuar procedura) me qëllim të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor , fetar apo etnik apo grupet tjera të tilla qe jetojnë në Republikën e Kosovës në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik ka shkuar në shkollën fillore “P. S.” që gjendet këtë fshat në të cilin zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe dhe atë pas marrëveshjes paraprake me të miturin F. S takohen në oborrin e kësaj shkolle ku i mituri F. kishte marrë një litër verë dhe një sprejë me ngjyrë të kuqe “AEROSOL” me të cilin të pandehurit kishin shkruar grafit në alfabetin cirilicë në muret e kësaj shkolle “Kosovo Je serce serbije” si dhe grafite nacionaliste me katër C dhe në këtë mënyrë kanë ndikuar në nxitjen e urrejtjes përçarjes ndëretnike kur dihet se në këtë fshat jetojnë shqiptarët, serbët dhe romët.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Nxitja e urrejtjes përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par 1 të KPRK-së*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43 69, 70, 71, 72 dhe 147 të KPRK-së dhe neneve 358, 359, 360 dhe 364 të KPPRK-së, të akuzuarin:

## E GJYKON

- I. Me **DËNIM ME GJOBË** në shumen prej 800.00 (tetëqind) Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 60 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- II. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 40 (katër dhjete) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 60 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.4376/17 të datës 10.11.2020, ndaj të akuzuarit J.J.për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale Nxitja e urrejtjes përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 09.01.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu dhe të pandehurit J.J. ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit J.J.qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Nxitja e urrejtjes përçarjes ose mos durimit

kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e dashjes dhe motivin racor të kryerësit me rastin e kryerjes së veprës penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 43 të KPRK-se të akuzuarin e gjykoi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL  
P.nr.2189/20 datë 18.01.2024**

**Gjyqtarja e vetme Gjykuese**

---

**Laura Hoti Statovci**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.